

**VENDIM**  
**Nr.885, datë 19.8.2009**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.115, DATË 2.2.2009 TË KËSHILLIT TË**  
**MINISTRAVE “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË PUNONJËSVE ME KONTRATË**  
**TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2009, NË DISA MINISTRI DHE INSTITUCIONE**  
**QENDRORE” , TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 18 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Pika 1 e vendimit nr.115, datë 2.2.2009 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Numri i punonjësve me kontratë të përkohshme, për vitin 2009, për ministritë dhe institucionet qendrore, është 2636 punonjës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data e miratimit të tij.

**KRYEMINISTRI**  
**Sali Berisha**

Lidhja nr.1

| <b>Grupi</b> | <b>Emri i institucionit</b>                                    | <b>Nr. i punonjësve</b> |
|--------------|----------------------------------------------------------------|-------------------------|
| 02           | Kuvendi i Shqipërisë                                           | 11                      |
| 03           | Këshilli i Ministrave                                          | 1                       |
| 04           | Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës               | 58                      |
| 05           | Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit  | 213                     |
| 06           | Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit | 815                     |
| 10           | Ministria e Financave                                          | 50                      |
| 11           | Ministria e Arsimit dhe Shkencës                               | 113                     |
| 12           | Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve            | 22                      |
| 13           | Ministria e Shëndetësisë                                       | 51                      |
| 14           | Ministria e Drejtësisë                                         | 31                      |
| 15           | Ministria e Punëve të Jashtme                                  | 16                      |
| 16           | Ministria e Brendshme                                          | 562                     |
| 18           | Shërbimi Informativ Shtetëror                                  | 40                      |
| 20           | Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave                            | 30                      |
| 25           | Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta | 87                      |
| 26           | Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave      | 140                     |
| 28           | Prokuroria e Përgjithshme                                      | 5                       |
| 30           | Gjykata Kushtetuese                                            | 2                       |
| 31           | Agjencia Telegrafike Shqiptare                                 | 4                       |

|    |                                    |             |
|----|------------------------------------|-------------|
| 50 | INSTAT                             | 378         |
| 63 | Këshilli i Lartë i Drejtësisë      | 2           |
| 77 | Autoriteti i Konkurrencës          | 2           |
| 82 | Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit | 1           |
| 87 | Institucione të tjera qeveritare   | 2           |
|    | <b>Totali</b>                      | <b>2636</b> |